



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Nr. 150/1 Prot

Tiranë, më 15/12/2019

VENDIM

Nr. 01, datë 15.2.2019

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesi, z. ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim quajtur “Komisioneri”) Formularin e Ankesës nr. 150 Prot., datë 30.01.2019, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”, kundër Autoritetit Publik “Bashkia Tiranë” (në vijim quajtur “Autoriteti Publik”).

Ankuesi, nëpërmjet kërkesës së datës 15.10.2018 ka kërkuar t’i vihet në dispozicion dokumentacioni në lidhje me përmbajtjen nën tokë në ambientet e bashkisë Tiranë, si më poshtë vijon:

- 1- Urdhërin nr. 25000, datë 27.06.2018, për “Ngritjen e grupit të konstatimit dhe verifikimit të dëmeve”, në bashkinë Tiranë;
- 2- Raportin përfundimtar të hartuar dhe që i është vendosur në dispozicion kryetarit të bashkisë Tiranë.

Autoriteti Publik, me shkresën nr. G- 26583/3 Prot., datë 02.11.2018 i ka kthyer përgjigje pjesërisht kërkuarit duke argumentuar se: “Në lidhje me dëmet e shkaktuara nga përmbajtja, vlerën e dëmeve dhe masat e marra për rikuperimin e tyre, jeni informuar zyrtarisht nga Drejtoria e Emergjencave Civile, me anë të shkresës nr. 39262 Prot., datë 22.10.2018.”

Ankuesi, pas përgjigjeve të dhëna nga Autoriteti Publik, pretendon se nuk i është vënë në dispozicion dokumentacioni i kërkuar. Me pretendimin se është cënuar në të drejtën për informim, ka paraqitur fillimisht ankimin nr. 1705 Prot., datë 15.11.2018 pranë Zyrës së

Komisionerit duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit.

Pas shqyrtimit të ankesës dhe dokumentacionit bashkëlidhur, rezulton se, Autoriteti Publik i ka kthyer përgjigje pjesërisht kërkuarit lidhur me informacionin publik të administruar për dëmet e shkaktuara nga përmytja, vlerën e dëmeve dhe masat e marra për rikuperimin e tyre, por pa vendosur në dispozicion dokumentacionin e kërkuar, më konkretisht: *Urdhërin nr. 25000, datë 27.06.2018, për "Ngritjen e grupit të konstatimit dhe verifikimit të dëmeve", në bashkinë Tiranë; Raportin përfundimtar të hartuar dhe që i është vendosur në dispozicion kryetarit të bashkisë Tiranë.*

Në këto kushte, Zyra e Komisionerit, në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, si hap paraprak përpara marrjes së vendimit, me shkresën nr. 1705/1 Prot., datë 20.11.2018 ka kërkuar nga Autoriteti Publik rivlerësimin e dhënies së informacionit brenda datës 27.11.2018.

Gjithashtu, në ndjekje të procedurës, me qëllim marrjen e një vendimi sa më objektiv, në zbatim të nenit 24/3 të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit" në të cilin citohet se *"Me marrjen e ankesës, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale... Kur e sheh të nevojshme, zhvillon një seancë dëgjimore publike me pjesëmarrjen e palëve",* me shkresën nr. 1705/2 Prot., datë 06.12.2018, Komisioneri ftoi palët në seancë dëgjimore, e cila u zhvillua me praninë e ankuesit z. nga njëra anë dhe përfaqësuesve të Autoritetit Publik nga ana tjetër.

Gjatë seancës, përfaqësuesit e Autoritetit Publik, kërkuan kohë për t'u njohur me çështjen, pasi Drejtoria e Ankimeve pranë këtij autoriteti, e kishte të pamundur përfaqësimin e bashkisë në këtë seancë dëgjimore. Pas miratimit të kërkesës, përfaqësuesve të Autoritetit Publik në seancë iu la detyrë të vendosnin në dispozicion dokumentacionin e kërkuar nga

Duke qenë se detyrimi nuk është përmbushur, ankuesi ka vijuar me ankimin nr.150 Prot., datë 30.01.2019. Në këto kushte, Zyra e Komisionerit e konsideron të rivendosur në afat këtë ankesë, duke vijuar me procedurën e parashikuar në përputhje me nenin 24 të ligjit nr. 119/2014.

Pas konsultimit të legjislacionit përkatës dhe dokumentacionit të administruar, Komisioneri, vlerëson se, informacioni i kërkuar përmbush kërkesat e pikës 2, të nenit 2, të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", sipas të cilit *"informacion publik" konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik".*

Për sa më sipër, Zyra e Komisionerit vlerëson se, ekzistenca e dokumentacionit të mësipërm pavarësisht nëse ai është i prodhuar apo administrohet nga autoriteti publik, ngarkon me përgjegjësi, këtë të fundit për koordinimin midis drejtorive dhe ngarkimin e personave përgjegjës për dhënien e informacionit dhe vënien në dispozicion të tij kërkuarit.

Theksojmë gjithashtu se, Ligji për të Drejtën e Informimit ka për qëllim të nxisë përforsimin e integritetit, transparencës e të përgjegjshmërisë së Autoriteteve Publike. Njësitë e qeverisjes vendore kanë këtë detyrim edhe në zbatim të Kreut VI, të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, konkretisht, Neni 15 “Transparenca e veprimtarisë së njësisë të vetëqeverisjes vendore”, në të cilin parashikon se: “1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore garantojnë për publikun transparencën e veprimtarisë së tyre.”

Bazuar në pikën 3 të nenit 3 të ligjit sipërcituar, “Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit”.

E drejta për informim është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funkionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

Në këto kushte, në lidhje me ankesën e z. _____ ndaj Bashkisë Tiranë, Komisioneri vlerëson se ankesa është e bazuar në ligj dhe si e tillë ajo duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mos marrëveshjeve administrative”, i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Pranimin ankesës nr. 150 Prot., datë 30.01.2019 të z. _____, ndaj Autoritetit Publik “Bashkia Tiranë”, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare”.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar sipas objektit të kërkesës:
-Urdhërin nr. 25000, datë 27.06.2018, për “Ngritjen e grupit të konstatimit dhe verifikimit të dëmeve”, në bashkinë Tiranë;
-Raportin përfundimtar të hartuar dhe që i është vendosur në dispozicion kryetarit të Bashkisë Tiranë, brenda datës 22. 2. 2019.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
4. Ky vendim u shpall sot në datë 15. 2. 2019.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

